

GJYKATA E APELIT

Numri i rastit: PAKR 336/16

Data: 13 dhjetor 2016

Gjykata Themelore në Mitrovicë: P. nr. 51/2014

Gjykata e Apelit, në Kolegjin e përbërë nga Gjyqtari kryesues dhe raportues i EULEX-it Piotr Bojarczuk / gjyqtari i Gjykatës së Apelit Fillim Skoro dhe gjyqtari i EULEX-it Roman Raab si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Vjollca Kroci-Gërxhaliu, këshilltari ligjor të EULEX-it, duke vepruar si procesmbajtës.

Në rastin penal lidhur me të akuzuarin:

M.Z, emri i babës xxx, xxx, i lindur më xxx në xxx, komuna xxx, me banim në xxx, kosovar, xxx, me gjendje të mesme ekonomike;

I akuzuar me Aktakuzën PPS nr. 90/13 të datës 23 prill 2014 për veprat penale:

- Nën akuzën një: **Shkelja e fshehtësisë së procedurës** në kundërshtim me nenin 400 (2) lidhur me nenin 31 të KPK;
- Nën akuzën dy: **Pengim në tentativë i provave apo procedurës** në kundërshtim me nenin 28 dhe 394 (1) 1.7) të KPK-së;

Shpallet i pafajshëm në të dyja akuzat me Aktgjykimin P. nr. 51/2014 të datës 12 shkurt 2016 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës;

duke e shqyrtuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të paraqitur më 24 Maj 2016 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, kundër aktgjyimit të lartpërmendur;

duke marr parasysh përgjigjet e mbrojtësit të M.Z në ankesë, të paraqitur më 9 qershor 2016;

duke marr parasysh propozimin e Prokurorit të Apelit të paraqitur në Gjykatën e Apelit (në tekstin e mëtejme GJA) më 9 gusht 2016;

pas mbajtjes së seancës publike të GJA më 30 nëntor 2016;

duke diskutuar dhe votuar, në bazë të nenit 471 dhe 472 të KPP-së më 1 dhe 13 dhjetor 2016;

duke vepruar sipas neneve 389, 390, 394, 398 paragrafi (1) pika 1.2, neni 401 dhe 403 i Kodit të Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPP)

nxjerrë:

AKTGJYKIM

- Ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës e paraqitur kundër aktgjykimit P. nr. 51/2014 të datës 12 shkurt 2016 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, është refuzuar si e pabazuar;
- Aktgjykimi P. nr. 51/2014 i datës 12 shkurt 2016 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës është konfirmuar

ARSYETIM

I. RRETHANAT PROCEDURALE

Më 8 nëntor 2013 është nxjerrë një Aktvendim për fillimin e hetimeve i datës 6 nëntor 2013 kundër të pandehurit. Më 23 prill 2014, prokurori paraqiti në Gjykatën Themelore të Mitrovicës aktakuzën PP nr. 90/13 e datës 23 prill 2014 kundër **M.Z** dhe Rr.R.

Më 15 maj 2014 është mbajtur një seancë fillestare. Gjatë seancës, të pandehurit u deklaruan të pafajshëm. Kundërshtimet ndaj provave të paraqitura në Aktakuzë dhe një kërkesë për hudhjen e aktakuzës janë parashtruar nga avokati mbrojtës Gafur Elshani, në emër të **M.Z**. Më 30 korrik 2014, kryetari i trupit gjykues lëshoi një Aktvendim P. 51/14 pjesërisht duke i dhënë vërejtje pranueshmërisë së provave dhe duke refuzuar kërkesën e mbrojtjes për hudhjen e Aktakuzës, duke e dërguar çështjen për shqyrtim gjyqësor. Aktvendimi u vërtetua nga Gjykata e Apelit më 25 shtator 2014.¹

Seancat kryesore publike janë mbajtur më 13, 14 dhe 15 tetor 2015 në 08, 09, dhe 10 dhjetor 2015 dhe më 02, 03, dhe 10 shkurt 2016 dhe pjesërisht të mbyllura për publikun më 02 shkurt 2016. Pas mbajtjes së seancave gjyqësore, aktgjykimi është shpallur më 12 shkurt 2016. Gjatë seancës së 10 shkurt 2016, prokurori paraqiti në gjykatë një njoftim për tërheqjen e akuzave kundër të pandehurit Rr. R. në pajtim me nenin 52 të KPP-së

¹ Aktvendimi i GJA PN 475/201

Aktgjykimi është shpallur më 12 shkurt 2016. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit **M.Z** dhe avokatit të tij mbrojtës Gafur Elshani më 10 maj 2016. Aktgjykimi i është dorëzuar PSRK-së më 10 maj 2016. Ankesa është paraqitur nga PSRK-ja në 24 Maj 2016 dhe i është dorëzuar mbrojtjes për përgjigje më 30 maj të vitit 2016. Përgjigja në ankesë ishte paraqitur nga avokati mbrojtës i **M.Z**, më 9 qershor 2016.

Rasti u transferua në GJA më 15 qershor 2016. Në të njëjtën ditë rasti është dërguar në zyrën Prokurorisë së Apelit është kthyer në GJA më 10 gusht 2016.

Seanca e Kolegjit të Gjykatës së Apelit (në tekstin e mëtejme Kolegji) u mbajt më 30 nëntor 2016 në praninë e Prokurorit të Apelit dhe mbrojtësit të pandehurit, Gafur Elshani. Njoftimi për seancën e Kolegjit të Ankesave i është dërguar **M.Z**. në kohën e duhur siç demonstron nga flete dërgesa, por ai nuk ka marrë pjesë. Kolegji e ka vazhduar seancën sipas nenit 390 paragrafi 4 i KPP-së.

Kolegji diskutoi dhe votoi më 1 dhe 13 dhjetor 2016.

II. PARASHITRESAT E PALËVE

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka paraqitur ankesë me kohë, më 24 maj 2016 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Prokurori apelon vetëm shfajësimin e të pandehurit në lidhje me veprën penale të Shkeljes së fshehtësisë së procedurës². Ankesa është paraqitur në bazë të:

1. vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike
2. shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale

Në ankesën e tij, Prokurori argumenton se trupi gjykues nuk i ka marrë në konsideratë disa fakte themelore materiale. Në këtë mënyrë, gjykata ka arritur në një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Si rezultat i kësaj, trupi gjykues gabimisht e shfajësoi të akuzuarin **M.Z** nga akuza e Shkeljes së fshehtësisë së procedurës. Ai pohon se faktet materiale përbëjnë prova të besueshme dhe të sigurta se i akuzuari kishte njohuri se dëshmitari A ishte dëshmitar në rastin GJPP 27/12 (PPS 88/11). Prokurori thekson se trupi gjykues pranoi se dëshmitari A është marrë në pyetje nga i akuzuari, por arriti në përfundimin se provat e tilla nuk provuan se i akuzuari kishte zbuluar statusin e dëshmitarit. Prokurori në ankesën e tij kundërshton vlerësimin e gabuar dhe përcaktimin e fakteve dhe pohon se në bazë të fakteve materiale, të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor është provuar se i akuzuari me veprimet e tij ka shkaktuar zbulimin e statusit të dëshmitarit A.

Prokurori po ashtu pretendon se nuk kishte prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat dëshmojnë apo edhe sugjerojnë se i akuzuari ka qenë i autorizuar të zbulojë përmbajtjen e urdhrin mbrojtës. Ai më tej pohon se gjykata ka dështuar të provojë qëllimin e të akuzuarit për të shkelur urdhrin e Gjykatës.

² Ankesa e PSRK-së, faqe 3, pika 6 nën B, versioni anglisht i Ankesës

Prokurori vë në dukje se gjatë vlerësimit të provave të rastit në tërësi, duke përfshirë dëshmitë lidhur me akuzën e veprës penale të pengimit në tentativë të provave, trupi gjykues mori qëndrimin se përpjekjet e ndryshme të marra nga i akuzuari që dëshmitari A të pranojnë se ai ishte një dëshmitar, nuk përbën forcë ose detyrim.

Në lidhje me shkeljet esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, Prokurori pohon se aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së. Ai pretendon se aktgjykimi përmban një numër të kontradiktave apo mospërputhjeve që lënë dyshime nëse trupi gjykues i ka vlerësuar provat në mënyrë shteruese.

Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit të modifikojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të dënojë të akuzuarin për veprën penale të Shkeljes së fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me nenin 400 (2) lidhur me nenin 31 të KPK-së. Si alternativë, prokurori propozon re-kualifikimin e veprës penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës ose anulimin e aktgjykimin të Gjykatës Themelore dhe të dërgojë rastin për rigjykim dhe vendim sipas nenit 398 (1) 1.3) të KPP-së.

Përgjigje në ankesë

Mbrojtësi i të akuzuarit **M. Z.** ka paraqitur përgjigje në ankesë më 9 qershor 2016.

Mbrojtësi thekson se gjendja faktike në aktgjykim është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotësisht. Ai më tej thotë se në provat e dëgjua në shqyrtim gjyqësor nuk u gjet ndonjë pjesë e dëshmive për të treguar implikimin e të pandehurit **M.Z.** në këtë çështje penale. Në lidhje me pretendimin e Prokurorisë se i pandehuri ka shkelur urdhrin e gjykatës, avokati mbrojtës thotë se gjatë shqyrtimit kryesor, prokurori ka dështuar të vërtetojë këtë pretendim. Nuk ka asnjë pjesë në Urdhër që përmend gazetarin për ndonjë zbulim të materialit përkatës dhe të informacionit. Avokati mbrojtës më tej thekson se i pandehuri nuk kishte dijeni për ekzistencën as të Urdhrit dhe as që dëshmitari A është i mbrojtur. Ai e gjen gjykimin mirë të arsyetuar dhe pretendimet e Prokurorit në ankesën e tij si të pabazuara.

Në lidhje me shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, mbrojtësi thekson se aktgjykimi nuk përmban asnjë shkelje të procedurës penale. Pretendimet e prokurorit se gjykata e shkallës së parë ka kontradikta nuk janë të bazuara. Ai e gjen arsyetimin e aktgjykimin të kundërshtuar të drejtë dhe të ligjshëm. Avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata e Apelit të refuzojë ankesën e prokurorit dhe të vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në tërësi.

Propozimi i Prokurorit të Apelit

Prokurori i Apelit në mendimin e tij të datës 9 gusht 2016 të paraqitur në GJA thotë se ai pajtohet me arsyetimin e Prokurorit të PSRK-së të EULEX-it dhe argumentet në ankesën e tij. Ai thekson se ankesa e prokurorit është e argumentuar mirë.

Prokurori i Apelit i propozon Gjykatës së Apelit të pranojë ankesën e Prokurorit Special të EULEX-it dhe të dënojë të pandehurin **M.Z.** për kryerjen e veprës penale të Shkeljes së fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me nenin 400 (2) lidhur me nenin 31 të KPK-së . Ai më tej thekson se për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike siç janë ngritur në ankesën e prokurorit të EULEX-it së bashku me shkeljen esenciale të procedurës penale, aktgjykimi i Gjykatës Themelore duhet të ndryshohet dhe i akuzuari të dënohet ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet për rigjykim.

III. KONSTATIMET E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e kolegjit të Gjykatës së Apelit

Nuk ka vërejtje për përbërjen e kolegjit ose kompetencën e tij nga palët. Në bazë të nenit 472 (1) të KPP Kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e tij.

Në bazë të Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 2 Korrik 2014, rasti në fjalë është konsideruar rast në vazhdimësi dhe do të mbetet me Gjyqtarët e EULEX-it. Kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksionin mbi rastin dhe se Kolegji është kompetent për të vendosur çështjen përkatëse në përbërjen e dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor të apelit.

B. Pranueshmëria e ankesës

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është shpallur më 12 shkurt 2016. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **M.Z.** dhe avokatit të tij mbrojtës Gafur Elshani më 10 maj 2016. Aktgjykimi i është dërguar PSRK-së më 10 maj 2016. Ankesa është paraqitur nga PSRK-ja më 24 maj 2016, brenda afatit 15-ditor. Ankesa është gjithashtu e pranueshme si e parashtruar nga personi i autorizuar, në pajtim me nenin 380 (1) KPP.

C. Konstatimet mbi merita

Duhet të theksohet se, pasi që prokurori apelon vetëm shfajësimin e të pandehurit lidhur me veprën penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës, meritat e rastit do të jenë të fokusuara vetëm në këtë pikë.

Pretendimet e ngritura në ankesën e PSRK-së

1. Prokurori apelon vetëm shfajësimin e të pandehurit lidhur me veprën penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale dhe të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike

Në lidhje me shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, Prokurori parashtron se aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP. Ai pretendon se aktgjykimi përmban një numër të kontradiktave apo mospërputhjeve që lënë dyshime nëse trupi gjykues i ka vlerësuar provat në mënyrë të shterur.

Kolegji i GJA nuk pajtohet me këtë pohim. Aktgjykimi i kundërshtuar është shumë i detajuar dhe përmban elementet e kërkuara nga ligji në nenin 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 të KPP-së. Aktgjykimi i kundërshtuar jep përshkrim të plotë të fakteve vendimtare që çojnë gjykatën saktë të shfajësojë të pandehurin **M.Z.**

Kolegji i GJA konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar është arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të mjaftueshme. Lexoni së bashku me provat e tjera në shkresat e lëndës, ajo krijon pamje të qartë të ngjarjeve duke i mbështetur konstatimet e GJA-së.

Prandaj, kolegji i GJA i refuzon pretendimet e prokurorit në ankesën e tij, si të pabazuara.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve, PSRK në ankesën e tij thekson se materiali provave është vlerësuar gabimisht.

Është parashtruar nga Prokurori në Aktakuzë se **M.Z.**, nga 14 korriku 2013 dhe të 31 tetori 2013, duke vepruar me Rr. R., pa autorizim zbuloi informacionin lidhur me identitetin e dëshmitarit A, i cili ishte nën urdhër mbrojtës në procedurën penale GJPP 27/12 dhe se **M.Z.** e ka aranzhuar takimin me dëshmitari A më 29 dhe 30 tetor 2013 në restorantin Dibra në Skenderaj ku ka demonstruar në praninë e të tjerëve, se dëshmitari A është një dëshmitar i prokurorisë në rastin GJPP 27/12, pra pretendohet se **M.Z.** ka kryer veprën penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me nenin 400 (2) lidhur me nenin 31 të KPK-së

Kolegji tërësisht i ka shqyrtuar provat dhe konstatimet faktike në aktgjykimin e kundërshtuar (verzioni anglisht), dhe pajtohet në tërësi me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar ka analizuar në detaje provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me **M.Z.** Sipas mendimit të Kolegjit, Gjykata e shkallës së parë vjen në konkluzione logjike në vlerësimin e provave.

Kolegji i Apelit përkujton se kur ligji përcakton termat "vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike" dhe "vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike", i referohet gabimeve ose mungesave që lidhen me "faktet materiale" që janë kritike për aktgjykimin e arritur³. Vetëm nëse Gjykata Themelore ka bërë gabim

3 B.Petric, në Komentaret e neneve të Ligjit Jugosllav mbi procedurën Penale, botimi i dytë 1986, neni 366, par. 3

themelor kur ka bërë vlerësimin e provave dhe përcaktimin e fakteve Gjykata e Apelit do të përmbysë aktgjykimin.

Si parim i përgjithshëm, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në shqyrtim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmime gojore dhe deklaratave nga një panel i gjyqtarëve. Leximi i procesverbalit të provave që shqyrtohen në gjyq, megjithatë i besuar dhe i saktë, është gjithmonë një instrument më pak i besueshëm për vlerësimin e provave. Edhe shqyrtimi i dokumenteve dhe provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë në gjykim, sepse shpesh ato prova duhet të mbështeten dhe të përbëhen nga elemente të tjera dhe në varësi të shpjegimeve gojore nga dëshmitarët ose palët. Prandaj, siç pohohet nga kjo gjykatë, në raste të tjera "*është një parim i përgjithshëm i procedurave të apelit që Gjykata e Apelit duhet të rezervojë respekt për konstatimet e fakteve të arritura nga Trupi Gjykses, sepse është kjo e fundit e cila ishte vendosur për të vlerësuar provat*". Kjo është në përputhje me standardin e aplikuar nga Gjykata Supreme "*që t'i mos çrregullojë konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, përveç nëse provat në të cilat mbështetet gjykata nuk mund të jenë pranuar nga ndonjë gjykim i arsyeshëm i fakteve, ose kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar*".⁴

Duke pasur parasysh këtë, Kolegji i ka analizuar me kujdes provat në këtë procedurë penale së bashku me arsyetimin e Gjykatës Themelore në gjykimin kundërshtuar. Më tej, kolegji i ka shqyrtuar me kujdes argumentet e paraqitura në ankesë dhe propozimin e Prokurorit të Apelit.

Kolegji konstaton se nuk ka qenë e vërtetuar nga ndonjë dëshmi që **M.Z** duke vepruar me Rr. R. , pa autorizim zbuloi informacion lidhur me identitetin e dëshmitarit A, që ishte nën urdhër mbrojtës. Duhet të theksohet se gjatë shqyrtimit kryesor të datës 10 shkurt 2016, prokurori tërhoqi akuzën e Shkeljes së fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me nenin 400 (2) lidhur me nenin 31 të KPK-së kundër të pandehurit Rr. R., që u akuzua për ndarjen e dokumentit konfidencial me **M.Z.** që iu dorëzua nga Prokurori ekipit mbrojtës të S. L. lidhur me dëshmitarin A.

Nuk është e diskutueshme se **M.Z** u takua me dëshmitarin A me 29 tetor dhe 30 tetor të vitit 2013. Ajo që ka rëndësi është nëse **M.Z**, me veprimet e tij, zbuloi informacion për identitetin e dëshmitarit A, dhe se ai ishte nën urdhër mbrojtës. Siç është vlerësuar si duhet në gjykatën e shkallës së parë, provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk provojnë se **M.Z** zbuloi identitetin e dëshmitarit të mbrojtur A. Së pari, kolegji thekson se për të shkelur identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, kryesi duhet të kenë njohuri në lidhje me ekzistimin e Urdhrit dhe përmbajtjen e tij. Lidhur me këtë, është vërtetuar në mënyrë të saktë se në asnjë rast **M.Z** nuk kishte njohuri për ekzistimin e Urdhrit as para se ta takonte Prokurorin më 24 tetor 2013 dhe as pas takimit, për shkak se dëshmitari A nuk u diskutua kurrë mes **M.Z.** dhe Prokurorit. Kjo u konfirmua nga dëshmitari Alberto Pasquero në dëshminë e tij të dhënë para gjykatës më 2 shkurt të vitit 2016. Në të vërtetë, në dëshminë e tij ai shpjegoi në mënyrë të detajuar takimin ndërmjet Prokurorit dhe **M.Z.** e që u mbajt më 24 tetor 2013. Dëshmitari Alberto Pasquero shpjegoi se **M.Z.** u thirr nga prokurori për ta informuar atë në lidhje me ekzistimin e urdhrit të disa dëshmitarëve, pa përmendur dëshmitarin A.

⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, AP –Kzi 84/2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30

Ai më tej thotë se **M.Z** është thirrur në cilësinë e dëshmitarit, por "biseda u zhvillua në mënyrë miqësore". Dëshmitë tregojnë se qëllimi për të intervistuar **M.Z** si dëshmitar është për shkak se prokuroria kishte informacion se ai kishte intervistuar disa persona të caktuar dhe se këto tregime janë transmetuar në media dhe për të për të shmangur më shumë emra të transmetuar, prokurori e ftoi **M.Z** për ta informuar atë në lidhje me ekzistimin e urdhrit. Duhet të theksohet se dëshmitari A nuk ka qenë temë e diskutimit mes **M.Z** dhe Prokurorit e as dëshmitari A ishte subjekt i transmetimit televiziv. Gjegjësisht, **M.Z** asnjëherë nuk ka transmetuar diçka në lidhje me dëshmitarin A.

Ka qenë e provuar se, kur **M.Z** u takua me dëshmitarin A me 29 tetor 2013, ai kishte njohuri për ekzistimin e urdhrit por, nuk kishte njohuri nëse dëshmitari A ishte objekt i këtij urdhri. Gjithashtu është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë që **M.Z** nuk ishte në posedim të urdhrit dhe se një urdhër i tillë nuk është gjetur gjatë kontrolleve në banesën, punën dhe automjetin e **M.Z**. Megjithatë, kur analizohet sjellja e **M.Z** ndaj dëshmitarit A, duket se, siç është konkluduar në gjykatën e shkallës së parë, në asnjë rast **M.Z** nuk ia zbuloi identitetin e dëshmitarit A askujt, pa marrë parasysh nëse ai e dinte apo jo përmbajtjen e urdhrit. Më 29 tetor ai u takua me dëshmitarin A për të dëgjuar historinë e tij për atë se çfarë kishte përjetuar gjatë luftës dhe, pasi një prej pyetjeve për intervistë do të ishte nëse ai ishte dëshmitar në rastin e krimeve të luftës, **M.Z** kishte për të sqaruar me atë se nëse kjo ishte e vërtetë apo jo. Pasi që dëshmitari A ka mohuar se është dëshmitar në rastin e krimeve të luftës, më 30 tetor 2013, ai ia tregoi dëshmitarit një letër të improvizuar duke deklaruar se kjo është dëshmia e tij e dhënë para prokurorit në rastin e krimeve të luftës. Në lidhje me këtë, është parashtrësia e prokurorit se i pandehuri **M.Z** ka qenë në kontakt me provat në rastin e krimeve të luftës dhe se R. ia kishte siguruar **M.Z** një dokument të tillë. Kolegji konstaton se gjykata kurrë nuk e ka vërtetuar se dokumenti i cili i është treguar dëshmitarit A ishte deklarata e tij dhënë prokurorit, e as prokurori nuk ka sjellë prova të mjaftueshme para gjykatës së shkallës së parë për të konfirmuar pretendimet e tij në këtë drejtim. Edhe dëshmitari A vetë tha në shqyrtim gjyqësor se dokumenti i treguar atij në shqyrtim gjyqësor nuk ishte ai të cilin **M.Z** ia ka treguar atij në takimin e dytë më 30 tetor të vitit 2013. Në takimin e dytë, atij iu kishte treguar dokumenti me logon e EULEX-it , që më vonë u konfirmua se ai dokumenti i treguar dëshmitarit A më 30 tetor 2013, ishte dokumenti i improvizuar nga **M.Z**.

Sa i përket parashtrësës së Prokurorit që **M.Z** ia zbuloi identitetin e dëshmitarit të tjerëve ose M.M., Kolegji i GJA fuqimisht hedh poshtë këtë pretendim. Është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë që **M.Z** asnjëherë nuk e ka zbuluar informacion në lidhje me dëshmitarin A askujt. Identiteti dhe mundësia e të qenit dëshmitar i rastit për krime të luftës nuk u zbulua për publikun as për askënd nga **M.Z**. Sa i përket M.M., kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se M.M., kishte njohuri për gjendjen e dëshmitarit A, pasi ata ishin të afërm dhe jo se **M.Z** ia ka zbuluar informacionin konfidencial atij. Siç është elaboruar në mënyrë korrekte në aktgjykimin e kundërshtuar se *[... është e vërtetë se të dy takimet (ndërmjet **M.Z** dhe dëshmitarit A në 29 dhe 30 tetor 2013) u mbajtën në restorant dhe që njerëzit e tjerë ishin të pranishëm. Megjithatë, nuk ka prova të paraqitura të cilat tregojnë se këta njerëz kanë dëgjuar bisedën e tyre, ose e kanë kuptuar përmbajtjen e takimit. Në të dyja rastet, kameramani nuk është ulur me të pandehurin në të njëjtën tryezë].*

Kolegji nuk do të vlerësojë emisionit televiziv "xxx " të transmetuar në RTK i cili u realizua para takimit mes **M.Z.** dhe Prokurorit dhe pas këtij takimi, pasi dëshmitari A nuk ka qenë objekt i intervistave në këto transmetime televizive. Në përputhje me këtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur saktë se elementi objektiv i veprës penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës nuk është provuar. Siç parashikohet në dispozitat e KPP, objekt i veprës penale është element i detyrueshëm i Aktakuzës, se në rastin në fjalë, prokurori ka dështuar për të vërtetojë.

Sa i përket qëllimit eventual, si element subjektiv i veprës penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me nenin 400 (2) në lidhje me nenin 31 të KPK-së, kolegji shënon se prokurori gjithashtu ka dështuar në vërtetimin e këtij elementi. Nga provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor para gjykatës së shkallës së parë, gjykata nuk ka mundur të konkludoj ekzistimin e këtij elementi, pasi dëshmitë tregojnë se kur **M.Z** u takua me dëshmitarin A me 29 dhe 30 tetor 2013, ai nuk kishte njohuri rreth faktit që dëshmitari A është një dëshmitar i mbrojtur pasi që mbrojtja e dëshmitarit A ose ekzistimi i një urdhri nuk u diskutua në mënyrë të veçantë në takimin që pati me Prokurorin më 24 tetor 2013. Prandaj, kolegji pajtohet plotësisht me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë

Bazuar në atë që u tha më lartë, kolegji i Gjykatës së Apelit në tërësi pajtohet me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se **M.Z** e ka kryer veprën penale Shkelja e fshehtësisë së procedurës në kundërshtim me Neni 400 (2) në lidhje me nenin 31 të KPK-së. Kolegji konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban një përcaktim jo të plotë ose të gabuar të gjendjes faktike sepse saktësisht bëhet fjalë për një përfundim logjik në vlerësimin e çdo pjesë të provave duke justifikuar shfajësimin e të pandehurit. Prandaj, ankesa e PSRK-së refuzohet si e pabazuar mbi këtë bazë.

Për arsye të shtjelluara më sipër, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e prokurorit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e kundërshtuar.

Kolegji i GJA nuk ka gjetur shkelje sipas detyrës zyrtare/*ex officio*, sipas nenit 394 të KPP-së.

Siç u tha më lart, duke *vepruar* në bazë të neneve 389, 390, 394, 398 paragrafi (1) pika 1.2, neni 401 dhe 403 të KPP-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze

Gjyqtari kryesues:

Piotr Bojarczuk, gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Roman Raab, gjyqtar i EULEX-it

Fillim Skoro, gjyqtar i GJA

Procesmbajtës:

Vjollca Kroçi - Gërxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR nr. 336/16